



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1719/prot.
5

Tiranë më 14.12.2021

VENDIM

Nr. 59, datë 14.12.2021

PËR KONTROLLUESIN “ZYRA VENDORE ARSIMORE TIRANË”

Në mbështetje të neneve 29, 30 dhe 32 të ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale” i ndryshuar (në vijim, “Ligji”), neneve 77-112 të Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë” (në vijim, “Kodi i Procedurave Administrative”), procesverbalit të hetimit administrativ dhe provave të administruara në ngarkim të kontrolluesit Zyrës Vendore Arsimore Tiranë,

KONSTATOVA SE:

Në zbatim të Urdhrit nr. 155, datë 15.10.2021 të Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim, “Komisioneri”), si dhe në mbështetje të Rezolutës së Kuvendit të Republikës së Shqipërisë, datë 03.06.2021 “Për miratimin e veprimtarisë së Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale, për vitin 2020”, u krye hetimi administrativ pranë kontrolluesit Zyrës Vendore Arsimore Tiranë (në vijim, “Kontrolluesi”), me objekt:

- Zbatimi i ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, i ndryshuar, dhe akteve të miratuara nga Komisioneri në lidhje me mbledhjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale, gjatë kryerjes së aktivitetit nga kontrolluesi.

Komisioneri, pasi shqyrtoi relacionin e hetimit administrativ, procesverbalin e konstatimit dhe provat e administruara gjatë ushtrimit të hetimit pranë Kontrolluesit, vëren se:

1. Kontrolluesi mbledh dhe përpunon të dhëna personale për kategorinë e subjekteve të të dhënave “punëmarrës”, “nxënës”, “nxënës me aftësi të kufizuara”, “mësues”. Përpunimi i të dhënave personale kryhet në mënyrë manuale dhe nëpërmjet instrumenteve elektronike.

Lidhur me kategorinë e subjekteve të të dhënave “*nxënës me aftësi të kufizuara*” të dhënat grumbullohen në dosjet personale të krijuara nga psikologët. Kontrolluesi nuk ka parashikuar asnjë afat për kohën e ruajtjes së të dhënave personale sensitive, në kundërshtim me parimin e mbrojtjes së të dhënave personale, parashikuar në germën “d”, të pikës 1, të nenit 5 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, Kontrolluesi ka detyrim të përpunojë të dhënat personale dhe sensitive për aq kohë sa ekziston qëllimi për të cilin janë grumbulluar dhe përpunuar dhe në momentin që qëllimi ka përfunduar të realizojë shkatërrimin e tyre, në të kundërt përpunimi i mëtejshëm i të dhënave konsiderohet i paligjshëm.

2. Kontrolluesi nuk ka publikuar në faqen zyrtare <https://zvatirane.edu.al> “*politikën e privatësisë*” me qëllim informimin e subjekteve të të dhënave dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave personale, personin që do t'i përpunojë të dhënat, të drejtat ligjore që gëzojnë, afatin e mbajtjes së të dhënave, dhe masat e sigurisë, në kundërshtim me nenin 18 të Ligjit.

Zyra e Komisionerit vlerëson se çdo kontrollues që përpunon të dhëna personale, pavarësisht faktit nëse përpunimi bëhet në mënyrë elektronike apo manuale, si dhe pavarësisht faktit nëse mbledh apo jo të dhëna personale nëpërmjet faqes së internetit, ka detyrimin të publikojë “*Politikat e Privatësisë*”, pasi kontakti paraprak i çdo subjekti të dhënash realizohet nëpërmjet faqes së internetit. Në këtë kuadër, publikimi i “*Politikave të Privatësisë*” përmbush më së miri qëllimin e informimit.

3. Kontrolluesi në kuadër të garantimit të sigurisë së personelit ka instaluar një sistem kamerash CCTV për mbikëqyrjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme të institucionit, Kontrolluesi nuk informon subjektet e të dhënave mbi prezencën e sistemit të video-surveimit (CCTV), në kundërshtim me parashikimet e nenit 18 të Ligjit dhe Udhëzimit nr.3, datë 05.03.2010 mbi “*Përpunimin e të dhënave personale me sistemin e video surveimit në ndërtesa dhe mjedise të tjera*”, i ndryshuar (në vijim, “*Udhëzimi nr. 3*”).

Zyra e Komisionerit vlerëson se informimi i subjekteve të të dhënave personale mbi prezencën e sistemit të video-surveimit (CCTV) është një nga detyrimet bazë të Kontrolluesit pasi u jep mundësinë subjekteve të të dhënave personale të njihen me të drejtat që gëzojnë dhe mundësinë e ushtrimit të tyre në praktikë. Mos përmbushja e këtij detyrimi nga ana e Kontrolluesit mund të sjellë pasoja të rënda sa i përket privatësisë dhe përpunimit të të dhënave personale të subjekteve të të dhënave.

4. Nga verifikimi i kryer në regjistrin elektronik të subjekteve kontrolluese, në protokollin e Zyrës së Komisionerit si dhe nga hetimi administrativ i ushtruar, rezultoi se Kontrolluesi e ka përmbushur detyrimin për njoftim në zbatim të nenit 21 të Ligjit. Nga ana tjetër, nga analizimi i përmbajtjes së njoftimit, rezultoi se Kontrolluesi nuk ka kryer përditësimin përkatës për ndryshimin e gjendjes së njoftimit të përpunimit të të

dhënave. Ky detyrim është përmbushur nga Kontrolluesi pasi ka filluar hetimi administrativ.

Zyra e Komisionerit vlerëson se realizimi i detyrimit për njoftim dhe përditësimi mbi përpunimin e të dhënave personale, është i rëndësishëm, pasi i jep mundësinë subjekteve të të dhënave që të informohen për përpunimin e të dhënave të tyre, nga ana e Kontrolluesit, si dhe në realizimin e detyrimeve ligjore të këtij të fundit. Kjo i jep mundësi reale subjekteve të të dhënave për të ushtruar të drejtat e tyre sipas Ligjit.

5. Kontrolluesi disponon rregullore "*Për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale*" por, konstatohet se rregullorja nuk parashikon proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative në funksion të veprimtarisë së kontrolluesit, kriteret e ligjshmërisë së përpunimit të të dhënave të nxënësve, sidomos të atyre me aftësi të kufizuara, masat për garantimin e kontrollin e veprimeve të personave/personelit që ka pasur dhe/ose ka akses në këto të dhëna, si dhe për mënyrën e shkatërrimit të tyre kur të jetë përmbushur qëllimi i përpunimit të tyre me qëllim garantimin e përpunimit të ligjshëm dhe sigurisë së të dhënave.

Zyra e Komisionerit vlerëson se është i nevojshëm rishikimi i këtij akti, ku të parashikohen rregulla dhe procedura organizative specifike (mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjekti të dhënash), sigurinë e të dhënave, konfidencialitetin, afatet e mbajtjes së të dhënave, etj.), konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit

6. Kontrolluesi nuk ka ndërmarrë masa konkrete në kuadër të trajnimit të punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale lidhur me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale. Rezulton mosplotësim të detyrimeve në lidhje me ngritjen, administrimin dhe mirëmbajtjen e sistemit të menaxhimit së sigurisë së informacionit (SMSI) lidhur me mbrojtjen e të dhënave personale, të parashikuara nga Udhëzimi nr. 47, datë 14.09.2018 të Komisionerit "*Për përcaktimin e rregullave për ruajtjen e sigurisë së të dhënave personale të përpunuara nga subjektet përpunuese të mëdha*", (në vijim, "*Udhëzimi nr. 47*").

Zyra e Komisionerit vlerëson se, për shkak të cilësisë si subjekt përpunues i madh, si dhe për shkak të natyrës së veprimtarisë që ushtron, kjo e fundit kërkon masa të shtuara teknike dhe organizative për garantimin e sigurisë së të dhënave personale, kontrolluesi është i detyruar të krijojë, mirëmbajë dhe administrojë SMSI në përputhje me parashikimet e Udhëzimit nr. 47.

7. Në kuadër të verifikimit të ankesës së z. ., administruar pranë Zyrës së Komisionerit, me nr.1645 prot., datë 06.10.2021 konstatohet se, Kontrolluesi administron 2 adresa zyrtare të postës elektronike (e-mail) dhe të gjithë punëmarrësit komunikojnë nëpërmjet postës elektronike personale. Nga një adresë personale e punonjësit të Kontrolluesit (email) është përhapur informacion në grup (saktësimi i të dhënave për SMIP) drejt të gjithë punonjësve të shkollave, për çdo shkollë, në kundërshtim me parimet dhe kriteret ligjore të mbrojtjes së të dhënave personale sipas parashikimeve në nenet 5 dhe 6 të Ligjit.

Të dhënat e përhapura konsistojnë në:

- a- Emër, atësi, mbiemër;
- b- Datëlindje;
- c- Vendlindje;
- d- Gjini;
- e- Pozicioni/posti i punës;
- f- Numri i urdhrin të punës;
- g- Data e urdhrin dhe data e vlefshmërisë së urdhrin.

Zyra e Komisionerit vlerëson se marrja e masave konkrete teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh të të dhënash), sigurinë e të dhënave, si dhe pajisjen e punonjësve me adresa emaili zyrtare, konsiderohet një detyrim shumë i rëndësishëm në zbatim të nenit 27 të Ligjit, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Në përfundim të hetimit administrativ, referuar provave dhe konstatimeve në vend, grupi i inspektimit hartoi procesverbalin përkatës i cili u nënshkrua nga përfaqësuesi i Kontrolluesit, duke u shprehur se pretendimet do i paraqisnin me shkrim.

Në respektim të së drejtës për t'u dëgjuar, në zbatim të neneve 87-89 të *Kodit të Procedurave Administrative*, Kontrolluesi është ftuar nga ana e Komisionerit përpara dhënies së vendimit të tij përfundimtar, të marrë pjesë në seancë dëgjimore.

Përfaqësuesi i Kontrolluesit, gjatë seancës dëgjimore të zhvilluar në datë 22.11.2021, ashtu si dhe në pretendimet me shkrim mbajti qëndrimin, si vijon:

- Sa i përket konstatimit në lidhje me afatin për kohën e ruajtjes së të dhënave personale për kategorinë “nxënës me aftësi të kufizuar”, kontrolluesi argumenton se afati i ruajtjes së dosjeve të hartuara në këtë kategori nxënësish është saktësuar në Urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë dhe se afati i ruajtjes së këtyre dokumenteve është 4 vjet.

Lidhur me këtë pretendim rezulton se, Kontrolluesi paraqiti Urdhrin e Ministrit të Arsimit Sportit dhe Rinisë mbi përcaktimin e kohës së ruajtjes së të dhënave vetëm gjatë seancës dëgjimore, dhe nuk e vendosi në dispozicion të grupit të hetimit administrativ gjatë procesit të kontrollit.

- Sa i përket konstatimit në lidhje me informimin mbi prezencën e CCTV, Kontrolluesi argumenton se, janë të afishuar dhe njoftimet bashkë me logon e kamerave të sigurisë, “Ambienti survejohet nga kamera”.

Zyra e Komisionerit vlerëson se, tabela informuese mbi prezencën e sistemit të video-survejit ka për qëllim informimin e subjekteve të të dhënave mbi përpunimin e të dhënave personale imazhe-video, ushtrimin e të drejtave të subjekteve të të dhënave në rast të cënimit të privatësisë, etj. Formatit i tabelës

informuese të vendosur nga Kontrolluesi nuk është në përputhje me standardin sipas Udhëzimit nr.3.

- Sa i përket konstatimit në lidhje me mospublikimin e “politikave të privatësisë”, Kontrolluesi argumenton se veprimtaria e punës së përditshme të Zyrës Vendore Arsimore Tiranë nuk është mbledhja e të dhënave personale të subjekteve, dhe për rrjedhojë nuk ka detyrim që të njoftojë subjektet mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale.

Referuar argumentimit të mësipërm, Zyra e Komisionerit vlerëson se, informimi i subjekteve të të dhënave të cilët vizitojnë faqen zyrtare, <https://zvafirane.edu.al> nëpërmjet Politikës së Privatësisë është një element tjetër tepër i rëndësishëm për të cilën kontrolluesi është përgjegjës në zbatim të Ligjit.

- Në lidhje me konstatimin e përditësimit të formularit të njoftimit Kontrolluesi argumenton se në zbatim të ndryshimit të legjislacionit mbi mënyrën e organizimit të institucioneve arsimore ka pasur ndryshim jo vetëm në mënyrën e organizimit, strukturës, por edhe veprimtarisë dhe detyrave konkrete të saj. Për rrjedhojë edhe përditësimi i njoftimeve që janë konstatuar nga ana e grupit të inspektimit do të reflektohen në vijimësi.
- Në lidhje me konstatimin se në rregulloren e hartuar nga Kontrolluesi nuk janë parashikuar proceset, procedurat, masat teknike dhe organizative në funksion të veprimtarisë së tij, Kontrolluesi argumenton se në këtë rregullore janë parashikuar të gjitha detyrat dhe të gjitha procedurat që ndjekin punonjësit e ZVAT të cilët gjatë kryerjes së detyrës së tyre funksionale hasen me të dhëna personale të subjekteve.

Zyra e Komisionerit vlerëson se rregullorja duhet të jetë gjithëpërfshirëse, duke përfshirë çdo lloj përpunimi të të dhënave personale, si dhe për çdo kategori subjektësh të të dhënave, sipas deklarimeve në “Formularin e Njoftimit”.

- Në lidhje me konstatimet se nuk janë marrë masa konkrete për trajnimin e punonjësve që kanë akses dhe përpunojnë të dhëna personale, Kontrolluesi argumenton se e ka të pamundur që të bëjë parashikime për kryerjen e prokurimeve publike për kryerjen e trajnimeve të tilla.
- Në lidhje me verifikimin e ankesës së z. A. SH, Kontrolluesi argumenton se për shkak të ngarkesës së madhe të punës dhe informacionet e shumta që kërkohen nga ana e institucioneve arsimore (144 shkolla publike, 58 shkolla jopublike, 45 kopshte publike, 149 kopshte jopublike) konstatimi i bërë në lidhje me e-mailin e dërguar nga specialistja është thjesht gabim njerëzor pa asnjë qëllim tendencioz.

Zyra e Komisionerit vlerëson se është përgjegjësi e Kontrolluesit marrja e masave konkrete teknike dhe organizative specifike mbi mënyrën e përpunimit të të dhënave personale (për çdo kategori subjektësh të dhënash), sigurinë e të dhënave,

si dhe pajisjen e punonjësve me adresa emaili zyrtare, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, duke mundësuar shmangien e pasojave të rënda që mund të vijnë për subjektet e të dhënave.

Në përfundim, shkeljet e konstatuara gjatë ushtrimit të hetimit administrativ, në kuptim të germave "a", "b", "d" dhe "dh" të pikës 1 të nenit 39 të Ligjit, përbëjnë kundërvajtje administrative dhe sanksionohen me gjobë, si më poshtë:

- a) kontrolluesit, që përdorin të dhëna personale në kundërshtim me kreun II "Përpunimi i të dhënave personale", dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- b) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të informuar, të përcaktuar në nenin 18 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 300 000 lekë;
- d) kontrolluesit, që nuk përmbushin detyrimin për të njoftuar, sipas përcaktimit në nenin 21 të këtij ligji, dënohen me 10 000 deri në 500 000 lekë;
- dh) kontrolluesit ose përpunuesit, që nuk marrin masat e sigurisë së të dhënave dhe nuk zbatojnë detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit, të përcaktuara përkatësisht në nenet 27 dhe 28 të këtij ligji, dënohen me nga 10 000 deri në 150 000 lekë;

Në bazë të pikës 2 të nenit 39 të Ligjit, personat juridikë, për kundërvajtjet e mësipërme administrative, dënohen me dyfishin e gjobës së përcaktuar në pikën 1 të këtij neni.

Për zgjedhjen e masës së gjobës, Zyra e Komisionerit ka parasysh faktin që, shkeljet e konstatuara janë serioze, dhe Kontrolluesi është në kushtet e nenit 30/2 të përsëritjes së shkeljeve dhe moszbatimit të Rekomandimeve të Komisionerit. Ndaj Kontrolluesit është ushtruar hetim administrativ, ku Komisioneri nëpërmjet Rekomandimit nr.18, datë 30.09.2016 ka orientuar Kontrolluesin për rikuperimin e shkeljeve të cilat binin ndesh me nenet 18, 21 dhe 27 të Ligjit.

PËR KËTO ARSYE:

Sa më sipër, në zbatim të neneve 5, 6, 18, 21, 27, 29, 30, 39, pika 1 germa "a", "b", "dh", si dhe nenet 40 dhe 41 të Ligjit,

V E N D O S A:

- 1- Dënimin e Kontrolluesit, me gjobë në vlerën 50.000 (pesëdhjetë mijë) Lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 5 të Ligjit;
- 2- Dënimin e Kontrolluesit, me gjobë në vlerën 20.000 (njëzet mijë) Lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 18 të Ligjit;
- 3- Dënimin e Kontrolluesit, me gjobë në vlerën 20.000 (njëzet mijë) Lekë, për shkelje të detyrimit të përcaktuar në nenin 27 të Ligjit;
- 4- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 18 të Ligjit, të marrë masa konkrete, për përmbushjen e detyrimit për informimin e subjekteve të të dhënave personale, për sa i përket tabelave informuese, si dhe mbi qëllimin dhe mënyrën e përpunimit të të dhënave,

duke i detajuar ato në funksion të aktivitetit të tij në faqen zyrtare, rubrika “politika e privatësisë”;

- 5- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 21 të Ligjit, të kryejë përditësimin e “Njoftimit” në vazhdimësi, për sa i përket ndryshimit të gjendjes së përpunimit të të dhënave personale të cilat ai përpunon;
- 6- Kontrolluesi, në zbatim të nenit 27 të Ligjit, të hartojë “Rregulloren për mbrojtjen, përpunimin, ruajtjen dhe sigurinë e të dhënave personale”, duke parashikuar masa konkrete teknike dhe organizative për mbrojtjen e të dhënave personale, dhe ato sensitive, mënyrat e përpunimit të të dhënave, të drejtat e subjekteve të të dhënave, etj., në funksion të aktivitetit të tij, për çdo proces përpunimi dhe /ose delegimi mbi përpunimin e të dhënave personale, të subjekteve të të dhënave personale;
- 7- Kontrolluesi, me qëllim garantimin e sigurisë së të dhënave personale duhet të zbatojë detyrimet e përcaktuara në Udhëzimin nr. 47, lidhur me krijimin, mirëmbajtjen dhe administrimin e Sistemit të Menaxhimit të Sigurisë së Informacionit (SMSI) për mbrojtjen e të dhënave personale;
- 8- Kontrolluesi në zbatim të pikës 1 të nenit 32 të Ligjit, të përmbushë detyrimet sipas këtij akti brenda afateve si vijon:
 - (i) brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, detyrimet e parashikuara në pikën 4 më sipër;
 - (ii) në vazhdimësi, detyrimin e parashikuar në pikën 5 më sipër;
 - (iii) brenda 45 (dyzetë e pesë) ditëve, detyrimet e parashikuara në pikat 6 dhe 7 më sipër.

Afatet e sipërpërmendura fillojnë nga data e marrjes dijeni të këtij akti.

- 9- Kontrolluesi të njoftojë Zyrën e Komisionerit për masat e marra.
- 10- Gjoha arkëtohet nga kundërvajtësi në Buxhetin e Shtetit, jo më vonë se 30 (tridhjetë) ditë nga komunikimi i këtij Vendimi. Me kalimin e këtij afati, ky Vendim kthehet në titull ekzekutiv dhe ekzekutohet në mënyrë të detyrueshme nga Zyra e Përmbarimit.
- 11- Kundër këtij Vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga komunikimi i këtij Vendimi.

Ky Vendim u shpall sot më datë/4.12.2021.

KOMISIONERI

Besnik Dervishi

